

Aurora MUKAJ ushtron detyrën e Këshilltarit Ligjor, pranë Njesisë së Mbështetjes së Komisioneve në Departamentin e Shërbimeve Ligjore të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, prej muajit Prill 2020. Në vitin 2011 ka përfunduar studimet e larta 5 vjeçare në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit të Sorbonne-Pantheon 1, Francë në “E Drejtë Ndërkombëtare”. Ka përfunduar studimet pas-universitare Master Shkencor në “E Drejtë Ndërkombëtare Tregtare” në Universitetin e Ottawa, Kanada.

Ka përvojë pune si në sektorin privat - publik vendas ashtu dhe atë ndërkombëtar. Gjatë periudhës së studimeve universitare ka punuar me kohë të pjesshme në sektorin e “Real-Estate” në Francë për një periudhë afro 3 vjeçare.

Gjatë periudhës Maj 2011 – Prill 2012, ka kryer praktikë pune një vjeçare në Sektorin e Përpunimit të të Dhënave Kriminale dhe në Drejtorinë Ligjore në Sekretariatit e Përgjithshëm të INTERPOL në Lyon, Francë.

Në vitin 2013, ka mbajtur për disa muaj pozicionin e Juristes në Departamentin e Programeve Ndërkombëtare në Agjencinë e Kërkimit, Teknologjisë dhe Inovacionit (AKTI) Tiranë. Prej muajit Korrik 2013 deri në Prill 2020 ka ushtruar detyrën e analistes në Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave (DPPPP) Tiranë.

Gjatë periudhës Shtator 2019 – Nëntor 2019 ka kryer një trajnim 3 mujor pranë Selisë Qendrore të Guardia di Finanza në Romë, Itali.

Zotëron njohuri shumë të mira të gjuhës angleze, franceze, italiane dhe turke.

Ka marrë pjesë në trajnime të organizuara nga Këshilli i Evropës, UNODC, OSCE, UNICRI, LIDERJUST, PAMECA IV, EGMONT GROUP, MONEYVAL, TRACFIN, NCA, FBI, European Fund for the Balkans dhe institucione të tjera.